



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës

Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo - The Competition Authority of the Republic of Kosovo

Nr. 58/2022

Datë: 20.12.2022

Mbështetur në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, nenin 11 paragrafi 1.2 dhe 3 me nën paragrafët 3.1 dhe 3.2, neni 13 paragrafi 1 me nën paragrafin 1.2, neni 15, neni 20 paragrafi 1 me nën paragrafin 1.2, neni 26 paragrafi 1.2, neni 27 paragrafi 2, neni 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, neni 37, neni 38, neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta zyrtare Nr.14/7 e dt. 07.06.2022); Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka kryer shqyrtimin paraprak të hetimit lidhur me dyshimin e arsyeshëm se ndërmarrjet Artmotion Sh.p.k. dhe Kujtesa Net Sh.p.k. kanë realizuar shitblerje të aksioneve në tregun përkatës, për të cilat përmbushet detyrimi ligjor për njoftimin e përqendrimit, si dhe Marrëveshje të ndaluar (kartel) apo praktikë të bashkërenduar. me këtë rast Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 20.12.2022, nxjerr:

K O N K L U Z I O N

për fillimin e procedurës hetimore ndaj:

- I.** Ndërmarrjeve **ARTMOTION Sh.P.K.** – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me numër unik identifikues: 810200866 me adresë: Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës - Zona Industriale, si dhe **KUJTESA Net Sh.P.K.** – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me numër unik identifikues: 810547862 adresa: Preoc, km. i 7-të Magjistranja, Prishtinë - Ferizaj, për shkak të dyshimeve të arsyeshme se të njëjtat kanë realizuar shitblerje të aksioneve dhe Marrëveshje të ndaluar (kartele) apo praktikë të bashkërenduar.
- II.** Autoriteti i Konkurrencës kërkon nga ndërmarrjet e lartcekura, si në pikën **I** të dispozitivit të këtij konkluzioni që në afat prej **30 ditësh** t'i sjellin në zyrat e Autoritetit këto dokumente:
 - a) Informatat e biznesit (Certifikatën e regjistrimit, Informacionet e biznesit dhe Certifikatën e numrit fiskal);
 - b) Pasqyrat financiare për vitet 2019, 2020, 2021;
 - c) Marrëveshjet (kontratat) për shitblerjen e aksioneve;
 - d) Kontratat apo marrëveshjet, për të gjitha kanalet që operatorët kanë në transmetim;
 - e) Korrespondencat me shkrim (dokumente, e-mail, etj) ndërmjet viteve 2019,2020,2021,2022;

- f) Listimin e plotë të pikave të prezencës (POP) të të gjitha pajisjeve transmetuese si, encoderet, përqesit, middleware, serverët;
 - g) Kërkojmë qasjen e plotë administrative në middleware;
 - h) Kontrata për shitblerjen e automjeteve për vitet 2019, 2020, 2021 deri me 30.11.2022;
 - i) Listën e të punësuarve për vitet 2019, 2020, 2021 deri më 30.11.2022;
 - j) Numrin e klientëve nëpër komuna, të listohen sipas fshatrave për vitet 2019, 2020, 2021, deri më 30.11.2022;
 - k) Ofertat për të gjitha kategoritë e shërbimeve për vitet 2019, 2020, 2021, deri më 30.11.2022;
- III.** Në rast se palët në procedurë nuk i dorëzon komentet dhe dokumentet e kërkuara si në pikën **II** të dispozitivit të këtij konkluzioni apo dorëzojnë dokumente të pa-sakta apo të rreme, Autoriteti do të konstatojë shkeljen e këtij ligji dhe do t'u shqiptojë palëve sanksionin administrativ deri në 1% të qarkullimit vjetor të vitit paraprak dhe më pastaj do të vazhdojë procedurën hetimore duke i përdorur mjetet tjera ligjore të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- IV.** Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, ka filluar monitorimin e tregut duke u bazuar në shkrimet e botuara në mediat elektronike dhe rrjete sociale. Andaj, Autoriteti pas mbledhjes së informatave lidhur me dyshimet për transaksionet e realizuara, rrjedhimisht blerjes së aksioneve apo fitimit të kontrollit mbi ndërmarrjet tjera në tregun përkatës, për të cilat dyshohet se përmbushin detyrimin për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim, bazuar në nenin 11 dhe 13, si dhe Marrëveshje të ndaluar (kartel) apo praktikë të bashkërenduar, bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta zyrtare Nr. 14/7, më tutje në tekst: LMK). Lidhur me këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës ka autorizuar monitorimin e tregut përkatës sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*) në zbatim të nenit 36 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.1.

PALË NË PROCEDURË:

Palët në procedurë të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës konsiderohen ndërmarrjet:

1. ARTMOTION Sh.P.K. – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe
2. KUJTESA Net Sh.P.K. Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.

PËRSHKRIMI I GJENDJES FAKTIKE:

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit në tregun e telekomunikimeve dhe kabllorë në territorin e Republikës së Kosovës, në bazë të informatave preliminare që posedon, ekziston dyshimi i arsyeshëm se: Ndërmarrjet ARTMOTION Sh.P.K dhe KUJTESA Net Sh.P.K., kanë realizuar blerjen e aksioneve të ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në tregun përkatës me aktivitetin primarë telekomunikimet kabllor.

Autoriteti konsideron se: Transaksionet/blerjet janë realizuar, pa e dorëzuar njoftimin e detyrueshëm për qëllimin e përqendrimit parashikuar sipas nenit 13 dhe 15 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Bazuar në nenin 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, parashihet së Pjesëmarrësit në përqendrim duhet t'i kërkojnë paraprakisht Autoritetit t'ua lejojë realizimin e përqendrimit të synuar nëse:

1.1. pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm; ose

1.2. së paku dy pjesëmarrës në përqendrim kanë mbi tre (3) milionë euro qarkullim në tregun e brendshëm.

Autoriteti konsideron se çdo realizim i përqendrimit të ndërmarrjeve nga neni 13 i këtij ligji, pjesëmarrësit e përqendrimit janë të detyruar ta njoftojnë Autoritetin, kur të plotësohen kushtet e përcaktuara, gjithashtu Neni 12 e përcakton shprehimisht se ndalohen përqendrimet që mund të shtrembërojnë ndjeshëm konkurrencën efektive, veçanërisht nëse përqendrimi i tillë ka si pasojë krijimin ose forcimin e pozitës dominuese, që nënkupton se lëndët e caktuara duhet t'i nënshtrohen paraprakisht vlerësimit nga Autoriteti i Konkurrencës.

Autoriteti konsideron se me marrëveshjen për realizimin e bashkimit apo blerjes së aksioneve të ndërmarrjeve, në treg ka një konkurrent më pak, rrjedhimisht zvogëlohet konkurrenca në tregun përkatës, kështu që ndërmarrjet janë të detyruara të paraqesin njoftimin për Përqendrim pranë Autoritetit, për arsye të vlerësimit të ndikimit ekonomik dhe juridik, respektivisht krijimit apo forcimit të Pozitës Dominuese, në tregun përkatës.

Me rastin e vlerësimit për arsyeshmërinë e marrjes së vendimit, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit që mund t'u paraqiten pjesëmarrësve të përqendrimit ose palëve të treta, si dhe efekteve të konkurrencës që mund të lindin nga zbatimi i përqendrimit.

Gjithashtu, Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun përkatës ka vërejtur se palët në procedurë ARTMOTIN Sh.P.K dhe KUJTESA Net Sh.P.K. kanë arritur Marrëveshje të ndaluar (kartelet) bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës apo praktikë të bashkërenduar duke:

- 1. Vendosur drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë caktuar çmimet e shitblerjes ose çdo kusht tjetër tregtimi;*
- 2. Kanë kufizuar ose kontrolluar prodhimin tregjet, zhvillimin teknike ose investimet;*
- 3. Kanë ndarë tregun ose burimet e furnizimit;*
- 4. Kanë zbatuar kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrjet tjera tregtare, duke i vendosur ato në pozitë të pafavorshme konkurruese si dhe;*
- 5. Kanë kushtëzuar lidhjen e kontratave me pranimin nga palët kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose përdorimi tregtar nuk kanë lidhje me objektin e kontratës;*

Andaj, nga sa u tha më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës hetimore nuk është e lejuar ankesa e as padia për iniciimin e konfliktit administrativ.

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI**

(_____)

Neime Binaku - Isufi
Kryetare

(_____)

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

(_____)

Nafije Osdautaj
Anëtare

(_____)

Besim Stublla
Anëtar

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- *Palët në procedurë*
- *Arkiva*